



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 151 / Prot.

Tiranë, më 14.01.2019

**VENDIM QARKULLUES**

Nr. 2, datë 14.01.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 26, DATË 30.05.2018 "PËR TARIFAT E APLIKIMIT DHE STUDIMIT PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË, TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË DHE CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE" NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019"**

Në mbështetje të pikës 3, neni 3, pika 27 e vijues e nenit 6, neni 47, pikës 1.a, të nenit 49, të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.778, datë 26.12.2018, "Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë" të ndryshuar", të Vendimit të Përbashkët nr. 72, datë 14.12.2018, të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, Vendimit nr 2, datë 14.01.2018, të Senatit Akademik, pasi mori në shqyrtim materialin e Administratorit të UMT-së "Propozim për pagesën e reduktuar 50% të tarifave të studimit",

**VENDOSI:**

1. Pika 1, e Vendimit nr. 26, datë 30.05.2018, të ndryshohet si më poshtë vijon.

1.a Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në një program të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, do të paguhet nga studentët në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, sipas tablës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

- 1.b Tarifat e vjetore të shkollimit për të gjithë studentët, që ndjekin studimet nga viti i dytë e lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, do të paguhet nga studentët në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, sipas tabeles 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë efektin financiar që rrjedh nga pagesa e reduktuar në masën 50% e tarifave vjetore të studimit për të gjithë studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, në vlerën:  
**84,591,688**, (tetëdhjetekatërmilione pesëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë, sipas tabelës nr.2, bashkëlidhur këtij Vendimi. Kjo vlerë duhet të rimbursohet nga fondet grant nga buxheti i shtetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**KRYETARI**  
**Adriana Berberi**  
*Adriana Berberi*



Tabela nr.1

Fakulteti	Cikli i studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore për program të parë (cikli i parë dhe i integruar)	Pagesa tarifës së shkollimit, program cikli i parë dhe i. Integruar, e reduktuar 50%.
Fakulteti i Mjekësisë	PIND*	Mjekësi e përgjithshme	45,000	22,500
Fakulteti i Mjekësisë	PIND*	Mjekësi e përgjithshme	29,888	14,944
Fakulteti i Mjekësisë	PIND	Farmacit	45,000	22,500
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	PIND	Stomatologji	45,000	22,500
Fakulteti i Mjekësisë	Bachelor	Shëndet publik	40,000	20,000
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Bachelor	Teknikë dentare	40,000	20,000
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Bachelor	Higjenist dentar	40,000	20,000
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Infermieri e përgjithshme	40,000	20,000
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Mami	35,000	17,500
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Fizioterapi	35,000	17,500
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Teknikë laboratorit	35,000	17,500
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Teknikë imazherie	35,000	17,500
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Logopedi	35,000	17,500
*PIND = Program i integruar i cikut të dytë				

Tabela nr.2

Nr	Emertimi i programit	Nr studenteve	Tarifa tavan	Vlera	Tarifa pergjys muar	Vlera	Efekti Financiar
I-	<b>Fakulteti i Mjekesise</b>						
1	Bachelor shendet publik	39	40,000	1,560,000	20,000	780,000	780,000
2	Mjekesi e pergjithshme cikel integruar						
a	Viti pare - viti i peste	1,369	45,000	61,605,000	22,500	30,802,500	30,802,500
b	Viti i gjashte	327	29,888	9,773,376	14,944	4,886,688	4,886,688
c	Farmacii viti pare -peste	490	45,000	22,050,000	22,500	11,025,000	11,025,000
	<b>Total Mjekesia</b>	<b>2,225</b>		<b>94,988,376</b>		<b>47,494,188</b>	<b>47,494,188</b>
II-	<b>Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike</b>						
	<b>Bachelor</b>						
a	Viti 1 Infermieri e Pergjithshme	243	40,000	9,720,000	20,000	4,860,000	4,860,000
b	Viti 1, fizioterapi, mami, teknik labor etj	206	35,000	7,210,000	17,500	3,605,000	3,605,000
c	Viti 2 Infermieri e Pergjithshme	252	40,000	10,080,000	20,000	5,040,000	5,040,000
d	Viti 2, fizioterapi, mami, teknik labor etj	203	35,000	7,105,000	17,500	3,552,500	3,552,500
e	Viti 3 Infermieri e Pergjithshme	248	40,000	9,920,000	20,000	4,960,000	4,960,000
f	Viti 3, fizioterapi, mami, teknik labor etj	137	35,000	4,795,000	17,500	2,397,500	2,397,500
	<b>TOTAL FSHMT</b>	<b>1,289</b>		<b>48,830,000</b>		<b>24,415,000</b>	<b>24,415,000</b>
III	<b>Fakulteti i Mjekesise Dentare</b>						
a	Bachelor ne teknik Dentar	60	40,000	2,400,000	20,000	1,200,000	1,200,000
b	Bachelor ne higjensit dentar	60	40,000	2,400,000	20,000	1,200,000	1,200,000
c	Stomatologji cikel i integruar	457	45,000	20,565,000	22,500	10,282,500	10,282,500
	<b>TOTAL STOMATOLOGJI</b>	<b>577</b>		<b>25,365,000</b>		<b>12,682,500</b>	<b>12,682,500</b>
	<b>TOTAL UMT</b>	<b>4,091</b>		<b>169,183,376</b>		<b>84,591,688</b>	<b>84,591,688</b>